



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 2762 / prot. 1

Tiranë, më 24.4.2024

UDHËZIM

Nr. 6, datë 24.04.2024

PËR

NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 3.4.2015 "PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E LICENCËS QË FITON KANDIDATI NË PËRFUNDIM TË PROVIMIT TË SHTETIT PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË MËSUESIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të shkronjës "d" të pikës 8 të vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të udhëzimit nr. 10, datë 3.4.2015, "Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit", të ndryshuar, pas profilit me numër rendor 26, të shtohet profili me numër rendor 27 si më poshtë:

"27. *Ekonomi, kodi 27*".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar, njësitë arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
OGERTA MANASTIRLIU

